



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.65/2019
Prishtinë, më 28.5.2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Lutfi Zharku, Liburn Aliu, Muharrem Nitaj, dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Glauk Konjufca, Memli Krasniqi, dhe Duda Balje, anëtarë.

Të ftuar: Shkumbin Hyseni, anëtar i Bordit të Drejtorëve të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave – ARH; Arben Krasniqi, drejtor i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë- ZKM.

Pjesëmarrës të tjerë: Zyrafete Krasniqi, Ilmi Ahmeti, Gëzim Qerimi dhe Marrjet Duraku – ARH; Alban Kaçiu, Laura Zeka, dhe Filloreta Bytyçi – ZKM; Blerta Bejtullahu, Zyra e BE-së; Lirdon Gashi – SEEF; Valtrim Hasani – KDI; Shpëtim Haziri – GP LDK; Vatra Qehaja – LVV; dhe Marigona Bajrami – GP-PSD.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, Veton Raci dhe Afrim Berisha praktikant.

Mbledhjen e kryesoi, Sala Berisha Shala, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 21.5.2019;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave – ARH për vitin 2018;
4. Diskutim lidhur me “Programin për zvogëlimin efektiv të barrës administrative në legjislacion dhe ekonomi”;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.5.2019;

Procesverbali i mbledhjes së datës 21.5.2019, u miratua pa vërejte

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave – ARH për vitin 2018;

Sala Berisha Shala, kryetare, theksoi se për sot e kemi në shqyrtim raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2018, dhe për të paraqitur këtë raport i kemi ftuar përfaqësuesit e ARH-së dhe ia kaloi fjalën z. Shkumbin Hyseni, anëtar i Bordit të ARH-së

Shkumbin Hyseni, ARH, theksoi se Autoritetit Rregullativ i Hekurudhave si agjenci e pavarur ushtron funksionin e vet në bazë të Ligjit të Hekurudhave të Kosovës nr. 04/L-063, ndërsa misioni e ka rregullimin, mbikëqyrjen dhe organizimin e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës. Gjatë vitit 2018, ARH-ja ka realizuar 100% obligimet që dalin nga Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, e njohur si PKZMSA. Kjo ka ndikuar pozitivisht në indikatorët matës që BE-ja ua bënë institucioneve të Republikës së Kosovës në raport me obligimet që rrjedhin nga MSA-ja. ARH-ja, ka edhe një të arritur tjetër që mendoj se bënë pjesë në institucionet më të suksesshme në vend: kemi përbushur 100 % të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017. Dhe, për më shumë, jemi ndër institucionet e vetme, apo mos të themi i vetmi institucion që si Organizatë Buxhetore nuk kemi asnjë të gjetur. Rrjedhimisht kjo tregon se të gjitha procedurat dhe proceset zyrtare, si në aspektin financiar po edhe administrativ janë respektuar në tërësi nga ana e jonë. Pra, ARH-ja nuk ka asnjë rekomandim të dhënë nga raporti final i Auditimit për vitin 2018. ARH-ja gjatë këtij viti raportues, ka pasuruar legjislacionin sekondar me 8 rregullore të reja, që ndërliken me kërkesat dhe nevojat e transportit hekurudhor në vend, Ligjin për hekurudhat, Traktati i Komunitetit të Transportit, PKZMSA-ja, etj. ARH-ja, në aspektin e përfaqësimit ndërkombëtar, ka vazhduar me angazhimin maksimal që të përfaqësohet sa më denjësisht. Rrjedhimisht, me përfaqësim zyrtar, anëtarësim dhe pjesëmarrje, sistemi hekurudhor në Kosovë, është më mirë se në vendet fqinje, por jemi të vetëdijshëm se ka vend për më shumë angazhim. Në fushën e rregullimit të tregut, ARH-ja ka kryer punën e vet me profesionalizëm duke trajtuar drejt të gjithë shqetësimet e ngritura. Në fushën e sigurisë, ARH-ja ka kryer inspektimet e nevojshme në bazë të ligjit dhe janë dhënë rekomandimet e nevojshme. Mbetet sfida e madhe ngritja e sigurisë hekurudhore. Për këtë kemi shtuar angazhimin, ku kemi realizuar takime me të gjitha udhëheqjet komunale të atyre komunave, ku kemi transport aktiv hekurudhor. Me këtë rast kemi vërejtur se disa komuna, kanë pasur edhe paqartësi rreth kompetencave që kanë. Në të gjitha rastet kemi pasur zotime se do merren masat në kuadër të përgjegjësisë për të përbushur kërkesat për rritje të sigurisë. Legjislacioni aktual, ka nevojë për ndryshime. Dualizmat që i lë ligji aktual në hartimin e legjislacionit sekondar, pastaj disa sfida që janë vërejtur në punë e sipër, disa mangësi që rregullojnë punën e departamenteve edhe brenda ARH-së e disa të tjera, janë arsye që na bëjnë të vlerësojmë se duhen bërë ndryshime konkrete. Kapacitetet jo të mjaftueshme të kuadrove në ARH. Rrezikojmë humbjen edhe të kuadrit aktual, sepse pagat janë të rregulluara sipas Ligjit të Shërbyesve civilë, ndërsa janë më të ulëta, madje edhe se pagat e sektorit hekurudhor në

Kosovë. Pavarësia jo e plotë financiare e ARH-së, për çka ceket si sfidë edhe në Raportin e progresit, të publikuar para 2 muajve dhe mbi të gjitha paqartësitë rreth pozicionit të ardhshëm të ARH-së, si agjenci, në kuptim të përcaktimit të statusit të sajë, pas ndryshimeve në kuadër të pakos së ligjeve për reformë në administratën publike. Ndryshimi eventual i statusit, do të thoshte me automatizëm largim të ARH-së nga disa mekanizma evropianë, ku jemi anëtarë me të drejta të plota si IRG etj., si dhe në disa tjerë që kemi status të vëzhguesit apo të avancuar, si ERA, etj. Për këtë, mendoj se duhet të analizohet me thellë çdo veprim para se të merret. Miratimi i TSI-ve, që janë rregulla të BE-së, që përcaktojnë kriteret teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe nënsistemet hekurudhore, të cilat pas miratimit nga ana e jonë do të jenë sfiduese për operatorët aktualë sepse kërkohen kriteret shtesë të cilat kanë kosto jo të vogël.

Kryetarja, i parashtroi disa pyetje për përfaqësuesit e ARH-së, si në vijim: Cilat janë vështirësitë kryesore ligjore në përgjithësi që e kanë përcjellë ARH-në në përmbushjen e misionit të ARH-së? Çka ka mbetur pa u përmbushë nga misioni i ARH-së për shkak të vështirësive ligjore? Çfarë po ndërmerr ARH-ja që vendkalimet ilegale të mbyllën ose të legalizohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme, sepse këto vendkalime janë burim i aksidenteve hekurudhore? Si dhe a janë mjaftueshëm të rregulluara dhe sinjalizuara vendkalimet legale? Sa kanë qenë vonesat në përgjithësi, dhe cili është roli i ARH-së për ndalimin apo lejin e operimit të kompanive në rast të mungesës së policës së sigurimit ndaj palëve të treta? Çka do të ndodhë në rast të aksidentit hekurudhor, ku do të mbetet përgjegjësia ndaj palëve të treta? Cilat janë gjetjet nga monitorimi i tregut hekurudhor në përgjithësi? Po ashtu raporti do të duhej të përmbante një pasqyrë se sa është i zhvilluar tregu hekurudhor, duke përfshirë frekuentimin e trenave dhe transportin e realizuar? A mund ta shpjegoni ndërlidhjen e dhënies së Autorizimit të sigurisë për ndërmarrjen “Infrakos” dhe në të njëjtën kohë në hekurudhë ka vendkalime ilegale hekurudhore? Takimet dhe bashkëpunimi me komunat, a është reflektuar në terren në përmirësim të nivelit të sigurisë hekurudhore? A mund të sqaroni se numri i aksidenteve nga vitet paraprake a është në rënie apo në rritje, dhe çfarë masash po ndërmerren që të parandalohen aksidentet hekurudhore? Ligji në fuqi, a paraqet problem në zbatim të detyrimeve ligjore të ARH-së dhe të rregullimit të sektorit hekurudhor? A ka nevojë të ndryshohet dhe plotësohet ligji, dhe nëse po, cilat janë arsytet pse duhet ndryshuar?

Lutfi Zharku, pyeti për statistikat e numrit të udhëtareve dhe të mallrave se sa është që e përdorin transportin e hekurudhave? A mund të na shpjegoni policen e sigurimit ndaj palëve të treta se si është e rregulluar? Lidhur më afatin e licencave sa është numri i revokimit të licencave?

Liburn Aliu, pyeti për çështjen e Ligjit për gjoba që nuk ka sjellë ndonjë efekt në transportin e hekurudhave, a mund të na qartësoni më shumë lidhur me këtë çështje ku është problemi? Si është gjendja në veri të Kosovës sa i përket lëvizjes së trenave ilegalë? Cilat janë planet për rehabilitimin e hekurudhave nga kredia e huazuar nga Banka për Rindërtim dhe Zhvillim–BRZH-i. Lidhur më marrëveshjen me Serbinë, cilat janë proceset që janë zhvilluar për hekurudha?

Shkumbin Hyseni, ARH, duke u përgjigjur në pyetjet e deputetëve theksoi: Sa i përket ligjit në fuqi për Hekurudhat e Kosovës, se a ka nevojë të ndryshohet dhe plotësohet ligji, tha që ka pasaktësi në disa raste, se kush i ka kompetencat dhe është përgjegjëse në mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe ARH-së, tek miratimi i legjislacionit sekondar të nxjerrja e akteve

nënligjore, se kush duhet ti miratojë, këto përgjegjësi, nuk e specifikon saktë ligji në fuqi dhe po ashtu tek kompetencat brenda ARH-së, ka paqartësi në mes departamenteve dhe bordit, lidhur më marrjen e vendimeve dhe këto janë disa probleme për Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave sa i përket ligjit në fuqi. Për numrin aksidenteve, tha se numri e aksidenteve hekurudhore që kanë ndodhur gjatë 2018, ka qenë 19 aksidente, ndërsa 3 (tre) persona kanë humbur jetën nga këto aksidente, këto kanë ndodhur për shkak të vendkalimeve ilegale, por shumica aksidenteve që kanë ndodhur janë në vendkalimet legale, të cilat janë në numër më të madh, diku rreth 260 vendkalime legale, ndërsa sa i përket vendkalimeve ilegale, ai tha se tani janë diku 32 të tilla, por që kanë probleme në mbylljen e tyre pasi, ato pas mbylljes hapen sërish. Rreth sigurimit të licencave për palët e treta, tha që është fundi i muajit dhjetor që ju kalojnë licencat, atëherë do shikohet se si do t'a rregullojmë këtë çështje. Për monitorimin e tregut, tha që është raport i ndarë nga raporti i përgjithshëm. Për numrin e udhëtarëve dhe mallrave, tha që është i vogël, krahasuar më vitet e tjera paraprake. Ndërsa, lidhur me Vendimin për ndalimin e trenave ilegale, potencoi se Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave edhe pse që nga janari i vitit 2017 ka marrë vendim për ndalimin e qarkullimit të trenave ilegale në veri, vetëm një është ndaluar, ndërsa dy të tjerë janë duke vazhduar të veprojnë ilegalisht në atë pjesë. Ai tha se ndalimi i këtyre trenave ilegale do të duhej të bëhej nga autoritetet tjera dhe se nuk e di pse. Për rehabilitimin e hekurudhave, tha që kanë filluar investimet për rehabilitim, përgjegjëse për investime është Ministria për Infrastrukturë, ndërsa ARH-ja e ka rolin e mbikëqyrjes së sigurisë të sektorit të hekurudhave. Lidhur më marrëveshjet më Serbinë, tha që nuk ka marrëveshje më Serbinë sa i përket hekurudhave, vetëm ka pasur diskutim që janë zhvilluar në Bruksel, por që nuk janë nënshkruar. Për Ligjin për gjoba, tha që ai ka qenë vetëm harmonizim më ligjin për kundërvajtje dhe asgjë tjetër.

Veton Berisha, pyeti për transportin e studentëve që udhëtojnë më tren, se a janë të liruar nga pagesa? Në zgjerimet e rrugëve magjistrale që po behën përgjatë hekurudhave sa po respektohet largësia nga brezi i hekurudhave?

Shkumbin Hyseni ARH, tha se për studentët dhe pensionistët është bërë lirimi 50% i biletave. Për zgjerimin e rrugëve, tha është kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës, por ka raste kur edhe ARH-ja, i inspekton këto punime dhe konsultohet me ministrinë për arsye të sigurisë.

Muharrem Nitaj, pyeti cila është qëndrueshmëria ekonomike e Hekurudhave të Kosovës, pasi që në raportin vjetor, mungon pjesa e raportit të monitorimit të tregut. Nuk e keni paraqitur se cila është gjendja reale e hekurudhave, a do të thotë kjo se për shkak të mospasqyrimit të gjendjes, i kemi hekurudhat në gjendje jo të mirë? Cilat kanë qenë veprimet e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për modernizimin e hekurudhave? Cili është numri i udhëtarëve që e shfrytëzojnë transportin e hekurudhave?

Shkumbin Hyseni ARH, sqaroi se sa i përket monitorimit të tregut dhe qëndrueshmërisë ekonomike të hekurudhave, që nuk është përfshirë në raportin vjetor, këtë e bën ministria përkatëse për Zhvillim Ekonomik, duke e matur performancën e ndërmarrjes publike se si po zhvillohen dhe shtoi se në bazë të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës, ARH-ja ka në përgjegjësi vetëm ofrimin e sigurisë së hekurudhave.

Pas diskutimeve, komisioni, me 5 (pesë) vota “për” dhe 1 (një) “abstenim”, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet raporti për vitin 2018 i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave – ARH.

4. Diskutim lidhur me “Programin për zvogëlimin efektiv të barrës administrative ne legjislacion dhe ekonomi;

Sala Berisha Shala, kryetare, tha sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, për të prezantuar këtë program e kemi ftuar përfaqësuesin e ZKM-së, z. Arben Krasniqi, drejtor i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë,

Arben Krasniqi, drejtor i Sekretariati Koordinues të Qeverisë, tha Qeveria e Republikës së Kosovës që nga viti 2016 është zotuar për zvogëlimin e barrës administrative që shkaktohet nga legjislacioni për shoqërinë dhe ekonominë. Në këtë drejtim, në po të njëjtin vit, Qeveria ka miratuar Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2.0 (2017-2021). Një prej qëllimeve kryesore strategjike është vlerësimi i mundësive për zhvillimin “e një programi për zvogëlim efektiv të barrës administrative”. Për arritjen e këtij qëllimi strategjik, Sekretariati Koordinues i Qeverisë ka zhvilluar Udhëzuesin dhe Doracakun për Zhvillimin e Koncept Dokumenteve, i cili përmban elemente të vlerësimit të ndikimit në kuadër të sistemit ekzistues të koncept dokumenteve. Në veçanti, për rastet e koncept dokumenteve të cilat kanë të bëjnë me legjislacionin, i cili përmban obligime për informata për bizneset, ofron mjetin e Modelit të Kostimit Standard, që duhet të përdoren për përllogaritjen e barrës administrative. Përveç kësaj, në vitin 2018 është zhvilluar edhe Doracku i Modelit të Kostimit Standard që përcakton metodologjinë për matjen e barrës administrative. Sipas kësaj metodologjie, barra administrative e ka formën e obligimeve që i imponohen bizneseve dhe qytetarëve në formë të informatave të obligueshme, siç janë: kërkesat për licencime, pëlqime, marrjen e lejeve, raportime të ndryshme. Kjo metodologji ofron mundësinë e përllogaritjes së opsioneve të ndryshme me qëllim të identifikimit të opsionit me barrën më të vogël për qytetarët dhe bizneset. Përmes kësaj arrihet nivel më i lartë i efikasitetit dhe efektivitetit në zbatimin e legjislacionit pa dëmtoar qëllimin e tyre. Në po të njëjtin vit, Qeveria ka emëruar grupin punues për Zhvillimin e Koncept Dokumentit për Zvogëlimin e Barrës Administrative. Analizat e bëra tregojnë se politika e propozuar do të ketë ndikime të konsiderueshme, si në buxhet ashtu edhe në ekonomi. Secili opsion parasheh angazhim intensiv të resurseve në zvogëlimin e barrës administrative. Në anën tjetër, analiza ekonomike tregon se zvogëlimi i barrës administrative, ndikon në rritje të aktivitetit ekonomik që rezulton me rritje të të hyrave tatimore.

Dardan Sejdiu, pyeti se a ekziston një inventarizim i dokumenteve nëse është bërë si duhet trajtimi i këtyre programeve në krahasim më vendet e tjera dhe nëse hiqet një dokument, mund të vijmë në përfundim që mund ta dëmtojmë të bërit biznes, prandaj duhet ta dimë mirë metodën që e kemi bërë që mos të e shkaktohet efekti negativ ekonomik. Po ashtu, kërkoj të di se a ka ndodh inventarizimi? Sejdiu propozoi që ZKM-ja, të hartojë një plan të veprimit për realizimin e këtij programi dhe ta njoftojë komisionin në baza të rregullta.

Liburn Aliu, kërkoi sqarime se a ka koordinim të këtyre projekteve dhe a është analizuar gjendja ekzistuese sa i përket këtyre programeve? Mandej, pyeti se sa është buxheti i projektit dhe kush e mbështet?

Lutfi Zharku, tha që në parim është për këtë program, por për të gjitha këto, duhet ta kemi një analize të ndarë, për çdo fushë veç e veç, si për sektorin e lejeve ashtu edhe për atë të licencave dhe tarifave.

Kryetarja, kërkoi sqarime lidhur më legjislacionin që është për barazi gjinore, se a e parasheh programi ndonjë projekt për të përkrahur këtë kategori?

Arben Krasniqi, ZKM, sqaroi se ideja e hartimit të këtij Programi për zvogëlimin efektiv të barrës administrative në legjislacion dhe ekonomi, është për ti përmbledhur gjitha dokumentet në një vend, të quajtur “ONE STOP SHOP”, ku do të ketë një plan për mënyrën e zbatimit të këtij programi. Për gjitha dilemat që u theksuan, jemi duke i bërë analiza ligjore veç e veç për çdo koncept dokument, qoftë për efektet pozitive dhe negative që mund t’i ketë. Ndërsa, lidhur mbështetjen, këtë program e mbështetë SIDA suedeze, ekspertiza nga Komisionin Evropian dhe analiza nga USAID-i. Po ashtu, tha se ky program do të shtrihet edhe nëpër komuna dhe do të ketë efekt si në nivel qendror dhe atë lokal.

Pas diskutimeve, komisioni, nxori këtë:

Përfundim

ZKM-ja të hartojë Planin e veprimit për mënyrën e realizimit të Programit për zvogëlimin efektiv të barrës administrative ne legjislacion dhe ekonomi, dhe ta njoftojë komisionin në baza të rregullta.

**5. Të ndryshme.
Çështjet vijuese**

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Sala BERISHA SHALA